

A do të më duhet të paraqes ndonjë dokumente?

Mund t'ju kërkohet të paraqisni dokumente në varësi të rastit për të cilin kualifikoheni. Përgatituni të paraqisni dokumente nga secila prej kategorive të mëposhtme. Nëse aplikoni në person, sillini me vete. Nëse aplikoni nga telefoni, do t'ju kërkohet t'i ngarkoni në MyChart ose t'i ofroni gjatë takimit tuaj. Nëse nuk keni dokumente të caktuara, mos u shqetësoni! Mund t'ju ndihmojmë gjithsesi.

Kategoria e dokumenteve	Shembuj të dokumenteve të pranuar
Dëshmi identiteti	Leje drejtimi ose letërnjoftim jodrejtuasi, ID NYC, pasaportë, letërnjoftim i huaj, kartë e gjelbër ose leje pune, certifikatë natyralizimi, viza, letërnjoftim shkolle, certifikatë martesë, certifikatë lindjeje, kartë EBT ose CBIC
Dëshmi të ardhurash	Fatura pagesazh (4 javët e fundit), letër punësimi, letër/ çek shpërblym me pension/SSI/ asistencë papunësie
Dëshmi adrese	Zarf me pullë postare, faturë e shërbimeve komunale (90 ditët e fundit), marrëveshje qiraje, deklaratë hipoteke
Vendimi i së drejtës për përfitim sigurimi	Nëse jeni depistuar një herë për të drejtën e sigurimit nga një asistues nga një organizatë tjetër apo juve vetë përmes New York State of Health Marketplace, paraqisni një kopje të vendimit (30 ditët e fundit)

Po në rast se marr një faturë ndërkohë që jam në pritje të një përgjigjeje lidhur me mbulimin tim me sigurim shëndetësor?

Nëse keni aplikuar për sigurime shëndetësore, nuk do t'ju kërkohet të paguani faturën gjatë kohës që aplikimi juaj është duke u shqyrtuar. Nëse merrni një faturë, duhet të na kontaktoni dhe të kërkoni të flisni me këshilluesin financiar i cili do t'ju vijë në ndihmë.


Si të aplikoj?

Konsulentët tanë financiarë mund t'ju ndihmojnë të aplikoni për mbulim sigurimi ose asistencë financiare. Telefononi nr. 1-844-692-4692 dhe zgjidhni opsionin 3 për të folur me një konsulent financiar.

NYC
HEALTH+
HOSPITALS



NDIHMJA FINANCIARE E NYC HEALTH + HOSPITALS



NYC Health + Hospitals ofron kujdes shëndetësor për të gjithë. Ne respektojmë të drejtat dhe privatësinë e të gjithë pacientëve, duke përfshirë edhe personat pa dokumente. Ne ndihmojmë edhe personat që nuk flasin anglisht të komunikojnë me mjekët dhe anëtarët e tjerë të personelit. Personeli ynë flet shumë gjuhë, duke përfshirë gjuhën shqipe, arabe, bengale, kineze, frënge, kreole haïtiane, hindi, koreane, polake, ruse, spanjolle dhe urdu. Ofrohen edhe shërbime interpretimi. Ju mund të merrni informacion në gjuhën tuaj.

Për më shumë informacion
dhe për regjistrim telefononi

1-646-NYC-CARE
1-646-692-2273

nyccare.nyc



QËNDRONI TË INFORMUAR. NA NDIQNI.

NYC
HEALTH+
HOSPITALS



NUK KENI SIGURIME SHËNDETËSORE? MOS U SHQETËSONI, NE MUND T'JU NDIHMOJMË.

Ju keni të drejtën për kujdes shëndetësor të përballueshëm dhe të cilësisë së lartë. Mënyra më e mirë për ta bërë këtë kujdes të përballueshëm është të regjistroheshi në një plan sigurimesh shëndetësore. Ne mund t'ju ndihmojmë duke ju shpjeguar zgjedhjet e disponueshme për ju dhe t'ju asistojmë gjatë regjistrimit në planin më të përshtatshëm për ju dhe familjen tuaj. Nëse nuk kualifikoheni ose nuk përballoni dot asnjë nga planet e disponueshme të sigurimeve shëndetësore falas ose me kosto të ulët, ju mund të kualifikoheni për një nga programet tona të ndihmës financiare – *NYC Care* ose *Options* – për t'i bërë shërbimet tona të kujdesit shëndetësor të përballueshme për ju dhe familjen tuaj.

Si mund të informohem mbi zgjedhjet e disponueshme?

Flisni me një këshillues financiar të NYC Health + Hospitals që mund t'ju ndihmojë ju dhe familjen tuaj të regjistroheshi në një plan sigurimesh shëndetësore falas ose me kosto të ulët, në rast se i plotësoni kushtet. Këshilluesit tanë financiarë janë këtu për t'ju ndihmuar të zgjidhni nga një shumëllojshmëri planesh për sigurime shëndetësore, për të cilat ju mund t'i plotësoni kushtet. Nëse nuk i plotësoni kushtet për asnjë plan sigurimesh shëndetësore, nuk përballoni dot mbulimin me sigurim, apo nuk keni para për të paguar për kujdesin mjekësor, ju mund të kualifikoheni për një programet tona të ndihmës financiare.

NYC Care është i disponueshëm për personat që nuk plotësojnë kushtet për sigurime shëndetësore apo që nuk mund t'i përballojnë ato, banues në qytetin e Nju Jorkut prej të paktën gjashtë muajsh.

Options ofrohen për njerëzit që nuk kualifikohen ose që nuk mund ta përballojnë sigurimin shëndetësor dhe jetojnë ose shkojnë në New York City. *Options* ndihmon personat që janë banues apo vizitorë në kontenë e Nassau-t dhe që përdorin spitalet dhe qendrat tona shëndetësore në Queens. *Options* ndihmon personat që janë banues apo vizitorë në kontenë e Westchester-it dhe që përdorin spitalet dhe qendrat tona shëndetësore në Bronx.

Pse është i rëndësishëm sigurimi shëndetësor?

Askujt nuk i pëlqen të lëndohet ose të sëmuret, por ngjarje të paparashikuara

mjekësore mund të ndodhin. Një plan sigurimesh shëndetësore ju ndihmon të paguani disa nga këto kosto të paparashikuara, duke përfshirë faturat mjekësore të vazhdueshme me vlera të mëdha dhe barnat me recetë, dhe mund t'ju ofrojë siguri. Ne dimë gjithashtu se personat me sigurime shëndetësore kanë më shumë gjasa të marrin kujdesin parandalues që ju duhet atyre dhe familjes së tyre për të qëndruar të shëndetshëm.

Sa do të paguaj?

Ofrohen shumë plane sigurimesh shëndetësore falas ose me kosto të ulët. Ne mund t'i diskutojmë këto zgjedhje me ju. Nëse nuk i plotësoni kushtet për sigurime shëndetësore dhe kualifikoheni për ndihmë financiare, ju do të paguani vetëm aq sa mund të përballoni. Grafiku në faqen vijuese tregon se sa mund t'ju kërkohet të paguani me një nga programet tona të ndihmës financiare. Tarifa që ju duhet të paguani për një vizitë të mjeku mund të jetë edhe \$0.

Çfarë më nevojitet për të aplikuar?

Do t'ju kërkohet të jepni informacion rreth vetes dhe familjes suaj dhe rreth të ardhurave tuaja. Ne do t'ju ndihmojmë të zgjidhni nga një shumëllojshmëri planesh sigurimi shëndetësor dhe programesh të ndihmës financiare për të cilat ju mund t'i plotësoni kushtet. Ky aplikim është i sigurt dhe asnjë informacion nuk ndahet me nëpunësit e emigracionit.

HAPI 1:

Gjeni madhësinë e familjes suaj (ju lutemi përfshini të gjithë të rriturit dhe fëmijët që jetojnë me ju).

HAPI 2:

Më pas, gjeni shumën që paguheni në vit në një nga nivelet.

HAPI 3:

Ndiqni kolonën deri në grafikun e fundit për të zbuluar se sa do t'ju kërkohet të paguani, sipas numrit të personave në familjen tuaj dhe të ardhurave tuaja familjare, për vizitat në klinikë, vizitat në urgjencë dhe shtrimet në spital.

NIVELET FEDERALE PËR VARFËRINË (FEDERAL POVERTY LEVELS, FPL)	100% FPL		101 - 125% FPL		126 - 150% FPL		151 - 200% FPL		201 - 250% FPL		251 - 300% FPL		301 - 350% FPL		351 - 500% FPL	
	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	
MADHËSIA E FAMILJES																
1	15,060	15,061	18,825	18,826	22,590	22,591	30,120	30,121	37,650	37,651	45,180	45,181	52,710	52,711	75,300	
2	20,440	20,441	25,550	25,551	30,660	30,661	40,880	40,881	51,100	51,101	61,320	61,321	71,540	71,541	102,200	
3	25,820	25,821	32,275	32,276	38,730	38,731	51,640	51,641	64,550	64,551	77,460	77,461	90,370	90,371	129,100	
4	31,200	31,201	39,000	39,001	46,800	46,801	62,400	62,401	78,000	78,001	93,600	93,601	109,200	109,201	156,000	
5	36,580	36,581	45,725	45,726	54,870	54,871	73,160	73,161	91,450	91,451	109,740	109,741	128,030	128,031	182,900	
6	41,960	41,961	52,450	52,451	62,940	62,941	83,920	83,921	104,900	104,901	125,880	125,881	146,860	146,861	209,800	
7	47,340	47,341	59,175	59,176	71,010	71,011	94,680	94,681	118,350	118,351	142,020	142,021	165,690	165,691	236,700	
Vizitat në klinikë për të rriturit	\$0	\$2	\$3	\$3	\$20	\$30	\$40	\$50	\$50	\$50	\$50	\$50	\$50	\$50	\$50	
Vizita në klinikë për fëmijët ose gratë shtatzëna	\$0	\$0	\$0	\$0	\$20	\$30	\$40	\$50	\$50	\$50	\$50	\$50	\$50	\$50	\$50	
Vizita në klinikë për shëndetin e sjelljes	\$0	\$0	\$0	\$0	\$15	\$30	\$40	\$50	\$50	\$50	\$50	\$50	\$50	\$50	\$50	
Vizita vetëm për vaksinë	\$0	\$0	\$0	\$0	\$0	\$0	\$0	\$0	\$0	\$0	\$0	\$0	\$0	\$0	\$0	
Vizita në urgjencë për të rriturit	\$0	\$3	\$3	\$3	\$75	\$80	\$100	\$120	\$120	\$120	\$120	\$120	\$120	\$120	\$120	
Vizita në urgjencë për fëmijët ose gratë shtatzëna	\$0	\$0	\$0	\$0	\$75	\$80	\$100	\$120	\$120	\$120	\$120	\$120	\$120	\$120	\$120	
Barna me recetë (tarifa për recetë)	\$0	\$2	\$2	\$2	\$6	\$10	\$14	\$18	\$18	\$18	\$18	\$18	\$18	\$18	\$18	
Ekzaminimi me rezonancë magnetike (Magnetic Resonance Imaging, MRI) ose kirurgjia ambulatorë	\$0	\$15	\$25	\$25	\$150	\$300	\$450	\$550	\$650	\$650	\$650	\$650	\$650	\$650	\$650	
Hospitalizimi*	\$0	\$25	\$25	\$25	\$150	\$400	\$900	\$1500	\$1500	\$1500	\$1500	\$1500	\$1500	\$1500	\$1500	
Bashkëpagesat dhe shumat e zbritshme	\$0	\$0	\$0	\$0	\$0	\$10	\$12	\$18	\$22	\$22	\$22	\$22	\$22	\$22	\$22	

Tarifat për pacientët me të ardhura familjare më të larta se vlerat e mësipërme do të faturohen mbi bazën e normës së Vetëpagesës (Selfpay) të NYC Health + Hospitals.

*Nëse kursimet tejkalojnë shumën \$8000, mund të faturohen tarifa shtesë.